



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.1373 Regj  
Nr.3748 Prot

Tiranë, më 26.10.2020

URDHËR  
“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

**Drejtuar:** Qendra Kombëtare e Biznesit  
**Adresa:** Tirane  
**Per dëjneni:** Tre Vellezerit Shpk me NIPT K31519060G  
**Adresa:** Farke LUNDER Rruga Tufa, Ndertesa nr 29, nr 31, Tel: 0682046089  
**Per dëjneni:** Autoriteti Kombëtar i Ushqimit  
**Adresa:** Rr. “Myslym Keta”, Tiranë

Unë, Resul Alushani, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës Përmbardimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr. 597 date 15.07.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbardimore Nr. 1373, Datë 06.10.2020, kërkesën e kreditorit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj debitorit Tre Vellezerit Shpk me NIPT K31519060G, në lidhje me titullin ekzekutiv “Proces-Verbal Inspektimi dhe Vendimi Perfundimtar Nr. AKU-TR-2018-002892-2-5 date 23.08.2018”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 3456 Prot, Datë 07.10.2020, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 597 date 15.07.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**KONSTATOVA:**

Debitori Tre Vellezerit Shpk me NIPT K31519060G, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit Tre Vellezerit Shpk me NIPT K31519060G, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues të K.Pr.Civile, si dhe të neneve 36 pika (e), 37 pikat (c) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit 26/2019 “Për Shërbimin Përmbardimor Gjyqësor Privat”, me qëllim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

**URDHËROJ:**

1. Qendra Kombëtare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore **Tre Vellezerit Shpk me NIPT K31519060G, me qëllim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi që do të sillte ndryshime në regjistrin tregëtar.**
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
RESUL ALUSHANI

